



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002235/7

Tiranë ___/___/2020

Lënda : *Rekomandojmë verifikimin e plotë të vjetërsisë së punës sipas listë-pagesave përkatëse të Ndërmarrjes Bujqësore Krumë e Fajza, Kukës, me qëllim përcaktimin e saktë të viteve të punës të shtetases Gj.S.*

Drejtuar: Znj. Anila SOKOLI
Drejtoreshë e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore

KUKËS

E nderuar Znj. SOKOLI,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, ka paraqitur ankesë shtetasi T.S, në përmbajtjen e së cilës ankohet për mosmarrje përgjigje lidhur me kërkesën e tij, për verifikimin e viteve të punës të bashkëshortes së tij, shtetases Gj.S.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë, shtetasi T.S, ka kërkuar verifikimin e vjetërsisë në punë të bashkëshortes së tij, Gj.S, por nga ana e punonjësve të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Kukës, ka

marrë përgjigje verbale se, nuk do kryejnë verifikimin e viteve të punës në arkivë.

Në kushtet e mosmarrjes së asnjë përgjigjeje zyrtare dhe gjendjes shëndetësore të tyre, shtetasi T.S, ka kërkuar ndërmjetësimin tonë institucional për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Siç jeni në dijeni, nga korrespondenca e kryer me institucionin që Ju drejtoni, me shkresën nr. 2932/1 datë 09.09.2020, jemi informuar si më poshtë:

“Lidhur me ankesën e paraqitur, nga verifikimi i bërë në bazën elektronike të vjetërsisë në punë që disponon arkivi i DRSSH-së Kukës, sipas fletës së regjistrit nr.1 të ish Ndërmarrjes Bujqësore Krumë, për personin me gjeneralitetet: Gj.S, me shënimin në fund të faqes “Datëlindja e korrigjuar, në rreshtin e parë të të dhënave u janë vënë vizë, në rreshtin e tretë data e fillimit në punë e korrigjuar”, janë të pasqyruara të dhënat si më poshtë:

-Në rreshtin e parë, të ketë punuar pranë Ndërmarrjes Bujqësore Fajza, si punëtore nga 17.12.1978, mungon data e largimit nga puna.

-Në rreshtin e dytë, të ketë punuar pranë Ndërmarrjes Bujqësore Krumë, si punëtore nga data 01.01.1980-09.06.1983.

-Në rreshtin e tretë, të ketë punuar pranë Ndërmarrjes Bujqësore Krumë, si punëtore nga 22.07.1983-31.07.1992.

Arkivi i DRSSH-së Kukës disponon dhe listëpagesat (bordero) për këtë subjekt, por verifikimi i tyre me listëpagesa bëhet vetëm me kërkesë zyrtare nga DRSSH-ja përkatëse, ku ka vendbanimin kërkuar, në momentin që i lind e drejta për përfitim nga skema e sigurimeve shoqërore”.

Nga përgjigja e ardhur rezulton se Arkiva e DRSSH-së, Kukës, disponon dokumentacion për të vërtetuar vjetërsinë e punës së shtetases Gj.S në N.B.Fajza, Kukës, por personi nuk mund të marrë informacionin e kërkuar, pasi duhet të presë datën e lindjes së të drejtës për përfitim.

Pavarësisht afateve të vendosura për paraqitjen e kërkesës për verifikim vjetërsie në punë, nga ankesat e adresuara pranë institucionit të Avokatit të Popullit ndër vite, kemi konstatuar se, për problemet e njohjes së vjetërsisë në punë, individë të ndryshëm kanë ndjekur rrugën gjyqësore. Përfundimi i procesit gjyqësor, i cili ka zgjatur më shumë se afati 2-vjeçar për të përfituar pension pleqërie nga momenti i lindjes të së drejtës për përfitim (paraqitja e kërkesës për verifikim të vjetërsisë në punë një vit përpara lindjes të së drejtës për përfitim dhe afati 1 vjeçar për kërkesën për caktim pensioni

pleqërie), ka sjellë për pasojë, mospërfitimin e pensionit të pleqërisë nga momenti i lindjes të së drejtës për përfitim me mbushjen e moshës sipas nenit 92 të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në kushtet që shtetases Gj.T, i lind e drejta për përfitim me 15.06.2023 dhe nga verifikimi i bërë mund të rezultojë se nuk figuron data e largimit nga puna në N.B.Fajza, Kukës, ajo duhet të ndjekë rrugën gjyqësore për njohjen e viteve të punës.

Pikërisht, për këtë problem dhe me qëllim që ajo deri në momentin e lindjes së të drejtës për përfitim të ketë mundësi të plotësojë edhe kriterin e vjetërsisë së punës e të fillojë të gëzojë pensionin e pleqërisë, kërkojmë të informohemi për vjetërsinë e punës së kësaj shtetaseje.

Qëllimi i së drejtës për informim ka të bëjë me garantimin e njohjes së publikut me informacion, me nxitjen e integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.

- Autoriteti publik është i detyruar të japë informacion dhe dokumentacion të prodhuar nga vetë autoriteti, nga autoritete të tjera publike, ose nga subjekte private, por që disponohen nga autoriteti publik.

Në këtë rast, DRSSH-ja Kukës disponon listë-pagesa (bordero) të Ndërmarrjes Bujqësore Fajza, Kukës.

Mbështetur në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar:

- *Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit original ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.*
- *Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta.*
- *E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton të drejtën për një jetë private, sekretin tregtar, të drejtën e autorit, patentat etj.*

Pra, informacioni i kërkuar për verifikimin e vjetërsisë në punë të shtetases Gj.T, nuk dëmton asnjë nga interesat e sipërcituara, por është një detyrim ligjor që rrjedh nga dispozitat e Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e

informimit”, i cili garanton të drejtën për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.¹

Sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : “Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDOJMË

Verifikimin e plotë të vjetërsisë së punës sipas listë-pagesave përkatëse të Ndërmarrjes Bujqësore Krumë e Fajza, Kukës, me qëllim përcaktimin e saktë të viteve të punës të shtetases Gj.S.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se; “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim...”, lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R

Vilma SHURDHA

¹ Neni 15, pika 5 I ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

